



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 13051 prot.

Tiranë, më 01/04/2020

URDHËR

Nr. 219, datë 01.04.2020

PËR

**NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 147, DATË 09.03.2020, "PËR NDERPRERJEN E
NDËRHYRJEVE KIRURGJIKALE TË PLANIFIKUARA NË QENDRËN
SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" DHE SPITALIN UNIVERSITAR
"SHEFQET NDROQI"**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit 10107 datë 30.03.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit nr. 9106 datë 17.07.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", Vendimit të datës 8.03.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri" si edhe udhëzimit nr 395 date 8.03.2020 të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Në pikën 1, të Urdhrit nr. 147, datë 09.03.2020, "Për ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjike të planifikuara në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi", togfjalëshi "deri në datën 3 prill 2020", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



MINISTRI

Ogerta Manastirliu